

VENDIM
Nr. 138, datë 7.6.2021

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RISHIKIMIN E “RREGULLORES PËR
PROCEDURAT DHE AFATET PËR DHËNIEN, MODIFIKIMIN, TRANSFERIMIN,
RINOVIMIN DHE HEQJEN E LICENCEVE NË SEKTORIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE”, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 109, DATË
29.6.2016, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 dhe 39, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të ligjit nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar; të nenit 15, 19 dhe nenit 26, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe të nenit 22, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licenceve në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.6.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 87/2 prot., datë 3.6.2021, të përgatitur nga Grupi i Punës, i ngritur me urdhrin e kryetarit të ERE-s nr. 1, datë 7.1.2021, ndryshuar me urdhrin nr. 01/1, datë 28.5.2021,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 109, datë 29.6.2016, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i ERE-s ka miratuar “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licenceve në sektorin e energjisë elektrike”. Më tej, me vendimin nr. 215, datë 20.12.2019, janë miratuar disa ndryshime në rregulloren e sipërcituar.

- Ndryshimet e ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, përkatësisht me ligjin nr. 61/2020, datë 14.5.2020, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 109, datë 9.6.2020, nuk afektojnë përcaktimet e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licenceve në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në nenin 39, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, është përcaktuar se ERE miraton rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin ose heqjen e licenceve, pagesat e aplikimeve për licencë, si dhe informacionin që duhet paraqitur në kërkesën për aplikim për çdo licencë.

- Ndryshimet e propozuara në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licenceve në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, janë të nevojshme në kuadër të përmirësimit të saj, si edhe janë bërë specifikimet në lidhje me mënyrën e pagesave të aplikimit, në përputhje me ligjin nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar.

- Po ashtu ndryshon dhe aneksi A, i cili tashmë është konceptuar si një format që plotësohet nga vetë aplikuesi, i cili duhet të plotësojë emrin e subjektit, NUIS-in, llojin e aplikimit dhe llojin e veprimtarisë, nënshkruhet në fund dhe depozitohet në ERE, me qëllim plotësimin elektronikisht të faturës përkatëse.

- Në aneksin A, janë bërë unifikime pagesash për disa nga veprimtaritë e sektorit të energjisë elektrike, duke u bazuar te fakti që procedura dhe volumi i dokumentacionit që shqyrtohet deri në miratimin e licencimit është e njëjtë. Pagesa për ndjekjen e procedurës së modifikimit të një licence vlerësohet të jetë sa $\frac{1}{2}$ e vlerës së pagesës për licencimin në të njëjtën veprimtari. Po ashtu,

vlerësohet se duhet unifikuar dhe pagesa për ndjekjen e një procedure njohje licence, për veprimtarinë e furnizimit dhe atë të tregtimit të energjisë elektrike.

- Përveç sa më sipër, në aneksin A, shtohet dhe një zë i ri, që është pagesa për lëshim dublikatë të licencës. Në rast se i licencuari humbet dokumentin origjinal të licencës, ai mund të bëjë një kërkesë në ERE për lëshim dublikatë licence, kundrejt pagesës prej 15 000 lekësh.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për rishikimin e “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, (ndryshimet e propozuara gjenden bashkëlidhur këtij vendimi).

2. Grupi i Punës të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti